



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 389/1 prot.

Tiranë më 6.3.2018

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektaktet

KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e vlerëson maksimalisht bashkëpunimin me institucionin tuaj nisur nga rëndësia dhe specifikat e proceseve përpunuese, të dhënave personale, subjekteve të të dhënave personale dhe objektivat që synohen të realizohen në zbatim të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në referim të nenit 3/5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, institucioni juaj konsiderohet kontrollues. Për pasojë veprimtaria juaj përpunuese duhet të kryhet në respektim të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të sanksionuara nëpërmjet këtij ligji specifik dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Komisioneri.

Referuar projektakteve të përcjella për mendim, paraprakisht vlerësojmë se në tërësi i plotësojnë kërkesat bazë ligjore të sanksionuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Vlen të theksojmë se përmbajtja e Projektregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK)”, implementon parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (sipas nenit 5 të Ligjit nr. 9887) dhe në të njëjtën kohë përpunimi i të dhënave kryhet për interesa publike dhe qëllime të ligjshme siç është rivlerësimi kalimtar i të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Pas analizimit të përmbajtjes së Projektregullores, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Referuar nenit 8, “Masat për sigurinë e të dhënave personale”, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave, është e nevojshme që për çdo proces përpunimi i të dhënave personale (manual ose elektronik) të ofrohet mundësia e gjurmueshmërisë (çdo veprim të lërë gjurmë). Kjo bëhet për qëllime sigurie dhe

provueshmërie dhe parashikohet si një risi edhe nga rregullorja e re evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 30 i saj).

Në këtë kuadër, në pikën 2 të këtij neni, të shtohet togfjalëshi, *"Mbajtjen e evidencave mbi çdo veprim me të dhënat personale që kryhet në format shkresor dhe/ose elektronik"*.

Përcaktimi i masave të sigurisë është një detyrim sipas nenit 27 të ligjit dhe nenit 7 të Konventës 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale". Masat e sigurisë duhet të jenë proporcionale:

- Në pikën 3 të nenit 20, është e nevojshme që të parashikohen rastet ose kriteret që duhen marrë parasysh për të vendosur mbi anonimizimin e të dhënave. Një parashikim i tillë do të shmangte subjektivizmin në marrjen e vendimit.
- Sa i përket kreut V, lidhur me të dhënat personale të personelit dhe vizitorëve, mund të referoni standardet dhe parimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 12 datë 21.12.2011 "Për kontrollin e identitetit në hyrje të ndërtesave", Udhëzimin nr. 40, datë 13.06.2014 "Mbi përdorimin e shërbimit të internetit dhe postës elektronike zyrtare në institucionet publike në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale" dhe Udhëzimin nr. 42, datë 22.07.2014 për "Përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë".

Gjithashtu, është e nevojshme që për kategoritë e subjekteve të të dhënave të parashikuara në Kreun V, të përcaktohen afate për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale (në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887). Përcaktimi i këtij afati duhet të kryhet në përputhje me qëllimin e përpunimit të të dhënave dhe për sa kohë ai ekziston.

Sa i përket "Deklaratës së konfidencialitetit", konstatojmë se reflekton standardin e miratuar dhe publikuar nga Zyra e Komisionerit në faqen zyrtare www.idp.al, i cili garanton një nga detyrimet kryesore siç është detyrimi për konfidencialitet, i sanksionuar në nenin 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Urdhri për emërimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, përbën një akt të rëndësishëm vlerësimi, përgjegjshmërie dhe serioziteti nga ana e institucionit tuaj, në frymën e përgjithshme të respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ekzistenca e një funksionari të tillë brenda strukturës tuaj është një domosdoshmëri jo vetëm referuar legjislacionit shqiptar por edhe atij evropian (referuar rregullores së re evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale GDPR), i cili do shërbejë si një urë lidhëse midis institucioneve tona.

Në përfundim, duke vlerësuar bashkëpunimin midis institucioneve tona shprehim gatishmërinë për të dhënë asistencën tonë me qëllim zbatimin sa më të mirë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

